



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 mars 2011  
Nr. ref.:RK93/11

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 84/10**

Parashtruesi

**Agim Stublla**

**VLERËSIM I KUSHTETUTSHMËRISË  
të**

**Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,  
PKL nr. 69/2010, të 6 gushtit 2010;**

**Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan,  
P. nr. 129/2009, të 23 shkurtit 2010;  
dhe**

**Vendimit të Policisë së Kosovës,  
P. nr. 122/VDP/2010, të 19 nëntorit 2010**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Agim Stublla, me banim në Podujevë.

### **Vendimi i kontestuar gjyqësor**

2. Vendimi të cilin parashtruesi i kërkesës e konteston është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës (Aktgjykimi PKL. nr. 69/2010, i 6 gushtit 2010), (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), me të cilin hidhej poshtë si e pabazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan (Aktgjykimi P. nr. 129/2009, i 23 shkurtit 2010), dhe Vendimit të Policisë së Kosovës (Vendimi P. nr. 122/VDP/2010, i 19 nëntorit 2010).

### **Çështja e lëndës**

3. Parashtruesi i kërkesës pohon për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

### **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

### **Procedura para Gjykatës**

5. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 13 shtator 2010.
6. Parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës më 9 nëntor 2010, nga i cili u kërkuar ta sqaronte, në përputhje me nenin 48 të Ligjit, shkeljen e supozuar të të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese. Edhe pse afati kohor për dhënien e sqarimeve mbaroi më 23 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë koment lidhur me këtë çështje.
7. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar të mos i zbulohet identiteti, por nuk e mbështeti me prova këtë kërkesë.
8. Kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme po të njëjtën ditë, më 9 nëntor 2010.
9. Më 23 shkurt 2011, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Gjyljeta Mushkolaj, e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues Almiro Rodrigues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri.

### **Përmbledhje e fakteve**

10. Më 7 mars 2009, parashtruesi i kërkesës, i cili punonte si polic në Aeroportin e Prishtinës, gjeti një telefon celular në tavolinën në të cilën ishte duke pirë kafe.
11. Parashtruesi i kërkesës pohon që e dorëzoi telefonin në sektorin e sendeve të humbura dhe të gjetura. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu pohon që kishte kërkuar dëftesë që e kishte dorëzuar telefonin në sektorin e sendeve të humbura dhe të gjetura, por atij nuk i ishte dhënë fare një dëftesë e tillë.

12. Pas një kohe, parashtruesi i kërkesës u arrestua dhe u mbajt 15 ditë në paraburgim.
13. Më 9 mars 2009, prokurori publik komunal në Gjykatën Komunale në Lipjan e akuzoi parashtruesin e kërkesës për vjedhje sipas nenit 252 (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Kushdo që tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm, për vete apo për personin, tjetër dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.
14. Më 4 shkurt 2010, avokati i parashtruesit të kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale në Lipjan ta shtynte seancën dëgjimore të 3 shkurtit 2010, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ishte në gjendje të qëndrueshme mendore për të marrë pjesë në seancë.
15. Më 23 shkurt 2010, Gjykata Komunale konstatoi që parashtruesi i kërkesës ishte fajtor, sepse me paramendim ishte përpjekur ta përvetësonte në mënyrë të paligjshme telefonin e sipërpërmendur celular për t'u pasuruar.
16. Parashtruesi i kërkesës u dënua me tre (3) muaj burg, të cilin nuk kishte nevojë ta vuante nëse brenda një (1) viti nuk do të kryente vepër tjetër penale.
17. Parashtruesi i kërkesës pohon që avokati i tij dështoi të ushtronte ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale.
18. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Supreme, të cilën e quajti "kërkesë për mbrojtje të jashtëzakonshme ligjore". Edhe pse një mjet i tillë juridik nuk ekziston, Gjykata Supreme e konsideroi atë si "kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë".
19. Gjykata Supreme (Aktgjykimi PKL. nr. 69/2010, i 6 gushtit 2010) e hodhi poshtë kërkesën si të pabazuar, sepse kërkesa nuk përmbante asnjë dëshmi për shkelje të ligjit dhe nuk i cekte dispozitat ligjore që kinse ishin shkelur.
20. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë nxori një vendim (Vendimi P. nr. 122/VDP/2010, i 19 nëntorit 2010), përmes të cilit parashtruesit të kërkesës ia shkëputi marrëdhënien e punës me Policinë e Kosovës për shkaqe disiplinore, një prej tyre ishte vjedhja e telefonit celular në Aeroportin e Prishtinës më 7 mars 2009.
21. Më 10 dhjetor 2010, shërbimi mjekësor i Policisë së Kosovës lëshoi një njoftim për gjendjen mendore të parashtruesit të kërkesës, duke thënë që parashtruesi i kërkesës kishte shkallë të ulët të tolerancës.
22. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes të cilës e kundërshtonte vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

23. Parashtruesi i kërkesës pohon se ishte rrahur nga policia dhe të burgosurit gjersa ishte në paraburgim.
24. Ai më tej ankohet se aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan është politikisht i motivuar dhe nuk është i bazuar në prova, por, në vend të kësaj, është i bazuar në rrena dhe i orkestruar nga qeveria aktuale.
25. Për më tepër, ai pohon që ishte kërcënuar edhe nga gjykata e sipërpërmendur.
26. Parashtruesi i kërkesës më tej pohon që nuk ka përdorur asnjë mjet të rregullt juridik kundër aktgjykimit të shkallës së parë, të 23 shkurtit 2010, sepse avokati i tij me qëllim

nuk kishte ushtruar ankesë në gjykatën e shkallës së dytë, edhe pse parashtruesi i kërkesës e kishte autorizuar të ushtronte ankesë.

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

27. Sa i përket pohimit të parashtruesit të kërkesës se është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, Gjykata vëren që për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
28. Sa i përket ankesës kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (Vendimi P. nr. 122/VDP/2010, i 19 nëntorit 2010), përmes të cilit parashtruesit të kërkesës ia shkëputi marrëdhënien e punës me Policinë e Kosovës, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes të cilës e kundërshtonte vendimin e sipërpërmendur. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk shfrytëzoi asnjë mjet tjetër juridik të paraparë me ligj.
29. Prandaj, sa i përket kësaj ankese, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i kishte në dispozicion sipas ligjit në fuqi.
30. Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar në ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë janë shkelur, si dhe pse janë shkelur, dhe as që ka dorëzuar ndonjë provë përkatëse dhe relevante.
31. Parashtruesi i kërkesës i ka dorëzuar disa dokumente. Megjithatë, ato nuk tregojnë që *“të drejtat dhe liritë e tij themelore, të garantuara me Kushtetutë, janë shkelur nga autoritetet publike”*.
32. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka shfrytëzuar asnjë mjet të rregullt juridik kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, të 23 shkurtit 2010. Pra, ai hoqi dorë nga e drejta për të ushtruar ankesë.
33. Për më tepër, kërkesa është dashur të parashtrohej në Gjykatën Kushtetuese brenda katër (4) muajve, duke filluar nga 23 shkurti 2010, data e aktgjykimit të Gjykatës Komunale. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese më 13 shtator 2010, d.m.th. pothuaj shtatë (7) muaj më vonë.
34. Prandaj, rezulton që kërkesa është e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shkurt 2010, Gjykata Kushtetuese, me shumicë votash,

## VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

Ky Vendim në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari Raportues**



Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani